

UDHËZIM
Nr. 17, datë 3.6.2015

PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT TË PËRQËNDRUAR
“SHËRBIM INTERNETI NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR
PËR VITIN 2015”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11, pika 1/b e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të nenit 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ligjit nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

UDHËZOJ:

1. Realizimin e procedurave të prokurimit për furnizimin me shërbimin e internetit për sistemin arsimor parauniversitar publik, me procedurën “Prokurim i përqendruar”, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit merr përsipër rolin e organit qendror blerës për zhvillimin e procedurës së prokurimit në emër dhe për llogari të njësive arsimore vendore (drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore) për shërbimin e internetit.

3. Të dhënat teknike/sasiore dhe fondi përkatës për kryerjen e këtij shërbimi përcaktohen dhe dërgohen të miratuara nga MAS, në formë të shkruar dhe elektronike (CD, *e-mail*), sipas informacionit të marrë nga çdo DAR/ZA.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, duke filluar nga njoftimi i kontratës deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.

5. Pas njoftimit të fituesit, Ministria e Arsimit dhe Sportit dërgon në çdo DAR/ZA dokumentacionin e plotë, në formë të shkruar dhe elektronike (CD), për të vijuar me nënshkrimin e kontratave përkatëse prej tyre.

6. DAR/ZA, brenda 5 ditëve pas nënshkrimit të kontratës, duhet të dërgojnë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit njoftimin e kontratës së nënshkruar në formë të shkruar dhe elektronike (CD), i cili do të do të hidhet në sistem elektronik nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

7. DAR/ZA-të janë përgjegjëse për ndjekjen e realizimit të kontratës.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit dhe drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT
Lindita Nikolla